



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS
Qytetërim Evropian

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore, 4 kredite, 20 leksione, 20 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri I/II

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në Gjuhën Greke dhe Angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Qytetërimi perëndimor është një nga qytetërimet më të rëndësishme përgjatë zhvillimit historik të njerëzimit. I lindur në pellgun mesdhetar ky qytetërim u shfaq në Greqinë e lashtë duke arritur një fazë zhvillimi të konsiderueshëm në raport me qytetërimet e tjera. Pas Greqisë qytetërimi vazhdoi mbi baza të forta përhapjen e thelbit të tij tek Roma, duke zhvilluar edhe një sërë aftësish të tjera që do të ndikojnë në mënyrë të pakthyeshme të gjithë europianët. Periudha mesjetare ishte një moment delikat në vazhdimësinë e tij duke shfaqur probleme të reja për Europën por njëkohësisht duke u orientuar drejt zgjidhjeve të reja të këtyre problemeve. Ndërsa proceset e Rilindjes , reformës fetare dhe zbulimeve gjeografike i dhanë Europës një hov të ri zhvillimi por edhe zgjerimi të ndikimit të panjohur ndonjëherë më parë. Konceptet e reja mbi shkencën, fenë, rolin e individit, strukturat politike filluan të jenë gjithmonë e më tepër vendimtare në lëvizjet e shumta shoqërore, politike dhe ekonomike. Një moment tjetër përcaktues kanë qenë edhe revolucionet liberale të cilat i dhanë këtij qytetërimi strukturën e sotme dhe e bënë atë të marrë një rol drejtues në zhvillimet globale.